

VENDIM
Nr. 798, datë 12.10.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 15.1.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE
RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT
NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE
PROFESIONALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të kreut II, të vendimit nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “a”, fjalët “... shoqëri tregtare të regjistruara ...” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë të regjistruar ...”.

b) Në shkronjën “e”, fjalët “... shoqëri tregtare ...” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe